



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QËNDRORE
KRYETARI

Adresa "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 1121/6 Prot.

Tiranë, më 30/11/2018

V E N D I M

Nr. 180, Datë 30/ 11 /2018

PËR
AUDITIMIN FINANCIAR
NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
PËR PERIUdhËN 01.01.2017 DERI NË 31.08.2018

Nga auditimi i ushtruar në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës rezultoi se, institucioni ka paraqitur drejtë transaksionet e veprimtarisë ekonomike financiare për periudhën e audituar duke reflektuar praktikat më të mira të raportimit financiar, në përgatitjen e pasqyrave financiare. Konstatuam një administrim të përgjegjshëm të vlerave materiale dhe monetare të vënë në dispozicion, në përputhje me rregullat buxhetore. Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit të brendshëm kanë funksionuar duke vlerësuar drejt risqet në realizimin e proceseve, arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Për auditimin financiar të ushtruar në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës sipas programit të auditimit nr. 1121/1 datë 08.10.2018, për veprimtarinë e ushtruar nga data 01.01.2017-31.08.2018.*

II. Të miratoj opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinionin:

KLSH ka audituar veprimtarinë e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe ISSAI 1700¹, dhe ISSAI 1200², si dhe në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Menaxhimi i UAMD është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Përgjegjësia e auditimit është të shprehet në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se aktiviteti është kryer në përputhje me kuadrin rregullativ dhe se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

I. Opinion mbi auditimin e pasqyrave financiare.

Nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, përse i takon shkallës së zbatimit nga subjekti UAMD-ës, të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit financiar), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti është paraqitur në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare, për vitin ushtrimor deri me 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar; pasqyra e performancës financiare; pasqyrën e flukseve monetare; pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; pasqyrën e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre; pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, pasqyrën e amortizimit të aktiveve, shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare.

Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se, bilancet, deklaratat e të ardhurave, shpenzimeve, banka janë përfshirë në deklaratat financiare. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të pakualifikuar për periudhën ushtrimore 2017-31.08.2018.

Opinionin i auditimit:

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet e mësipërme, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet material, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës në datën 31 dhjetor 2017 për të cilën **japim opinionin të pakualifikuar**³.

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përse i takon gjetjeve nga auditimi.

³ Një opinion i pakualifikuar jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njehsinë publike të audituar; dhe janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje: Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, por pa ndikim materiale në rezultatin e pasqyrave financiare. Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e pajisjeve elektronike janë klasifikuar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 218 “Inventar ekonomik”. Investimi i kryer në Godinën nr. 1 të Kampusit Universitar në shumën prej 145,200 lekë është klasifikuar në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 212 “Ndërtime e Konstruksione”. Gjithashtu u vërejt se fondi i librit është regjistruar në llogarinë 212 “Ndërtime e Konstruksione”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 32 “Objekte inventari”, veprime në mospërputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2016 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” i ndryshuar, Kapitulli V, pika 3 “Lista e llogarive”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 8-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1. Rekomandimi:

Nga Drejtoria e Financës në UAMD të marrë masat për të analizuar zë për zë këto llogari dhe më pas të bëjë sistemimin e tyre, duke bërë kalimin e shumave nga një llogari në tjetrën, me qëllim paraqitjen sa më të saktë të zërave të pasqyrës financiare për vitin 2018.

Menjëherë

2. Gjetje: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në formatin nr. 1 “Aktivet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar” janë të pasqyruara (llog. 202) “Studime dhe kërkime” në vlerën 765,000 lekë i zberthyer në mënyre analitike në këto nën zëra.

- Studim për Durrësin & Turizmin në vlerën 615,000 lekë

- Projekt për gjuhën në vlerën 150,000 lekë, projekte të blera që në vitin 2007, të cilat nuk janë më në funksion, si rrjedhojë nuk sjellin për institucionin as përfitime të ardhshme ekonomike. Në SKK nr. 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” dhe SNK 38 “Aktive jo materiale” thuhet se: Jeta e dobishme e një aktivi jo material që rrjedh nga të drejtat kontraktuale ose të drejta të tjera ligjore nuk duhet të kalojë periudhën e të drejtave kontraktuale ose të drejtave të tjera ligjore, por mund të jetë më e shkurtër në varësi të periudhës gjatë të cilës njësia pret të përdorë aktivin. Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje të bëjë një vlerësim të besueshëm të jetës së dobishme të aktivitetit jo material, jeta e dobishme do të supozohet që të jetë dhjetë vite. AQJM të regjistruar dhe në pronësi të UAMD kanë kaluar afatin 10 vjeçar dhe janë jashtë funksioni.

Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 8-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Rekomandimi:

Nga UAMD, të merren masat që komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve i ngritur nga NA i institucionit, të marrë në konsideratë dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të shumës prej 765,000 lekë të “Aktiveve të Qëndrueshme të pa Trupëzuar”.

Menjëherë

3. Gjetje: Nga auditimi i inventarizimit të aktiveve të realizuar sipas urdhrorit të Administratorit nr. 135 datë 30.11.2017, sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të nenit 12, pika 2 b dhe nenit 15 pika 4 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikat 73, 74 dhe pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe nenit 7 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet u konstatua se komisioni i

inventarizimit në procesverbalin e mbajtur për gjendjen e aktiveve nuk ka bërë një vlerë totale me listë të bashkëngjitur, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj etj. Për zërat e regjistruar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”, për një pjesë të tyre komisioni është shprehur se merr për bazë vlerën kontabël të regjistruar nga financa, me arsyetimin se komisioni nuk mund të analizojë zëra të investimeve, nuk mund të gjykojë se nëse aktivet që janë në magazinë figurojnë me ato që janë të regjistruar në kontabilitet. Në relacion nuk është paraqitur gjendja fizike e pajisjeve kompjuterike që UAMD disponon fizikisht, por vetëm një listë e atyre që komisioni propozon për dalje jashtë përdorimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 8-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3. Rekomandimi:

Komisioni i inventarizimit i ngritur nga NA të marrë masa në vazhdimësi, që të bëjë një ndarje e aktiveve gjendje që disponon institucioni, sipas zërave duke bashkëngjitur listën e tyre në relacionin drejtuar titullarit, me qëllim verifikimin reale të gjendjes së tyre, si dhe verifikimin më lehtësisht të diferencave të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet sipas zërave. Në momentin që komisioni i ngritur nuk arrin të bëjë inventarizimin e zërave të caktuar të kërkojë nga NA, për të ngritur grup pune me ekspertë të fushës, për aktivet që nuk mund ti inventarizojnë.

Vijimësi

4. Gjetje: Nga auditimi i zërave të pasqyrës financiare, në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në vlerën 10,597,873 lekë, e cila në analizë përbëhet nga 13 debitorë, ku vlera prej 1,056,699 lekë ka të bëjë me pagesa tepër ndaj stafit akademik për vitin 2013 të konstatuar nga auditimet e mëparshme dhe tatimin burim të paguar tepër për këto shuma në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrësit. Brenda kësaj vlere u konstatua se janë ngarkuar me detyrim persona të cilët aktualisht nuk janë më në jetë, detyrimi i cili konsideruar pa shpresë arkëtimi. Ndërsa vlera prej 850,000 lekë e tatimit në burim e paguar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, Durrësit nuk është arkëtuar edhe pas kërkesave të shumta bërë pranë kësaj drejtorie.

- Në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, u konstatua se vlera 463,000 lekë kishte të bënte me shumën që i është kërkuar stafi akademik për të kthyer mbrapsht shumën e përfituar për udhëtime dieta për mësim dhënien ditët e shtuna e të diela për periudhën 2013-2014 në degën e Peshkopisë, me arsyetimin se dieta të përfituar janë në ditë jozyrtare pune. Kjo shumë është kërkuar në kundërshtim me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 24, pika b) studime me kohë të pjesshme, të cilat zhvilloheshin gjatë fundjavës, si dhe vendimit të Senatit të UAMD nr 26, datë 10.09.2010.

Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 8-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4.1 Rekomandimi:

Nga Drejtoria e Financës së UAMD të rivlerësohen llogaritë e njësisë ekonomike për shumat pa shpresë arkëtimi të debitorëve të ndryshëm dhe të merren masa për të bërë veprimin kontabël dukë kredituar llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” dhe të debitohet llogaria 8424 “Transferim për debitorë te konstatuar e te ngjashme” për ato vlera.

4.2. Rekomandimi:

UAMD të kërkojë në rrugë zyrtare Drejtorisë Rajonale Tatimore, Durrës, që për vlerën 850,000 lekë, kjo drejtori të shpallë UAMD kreditore për tatimin burim

4.3. Rekomandimi:

Nga Drejtoria e Financës së UAMD të rivlerësohen llogaritë e njësisë ekonomike, për shumën 463,000 lekë dhe të merren masa për të bërë veprimin kontabël dukë kredituar llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” dhe të debitohet llogaria 8424 “Transferim për debitorë te konstatuar e te ngjashme” për këtë vlerë.

Menjëherë

5. Gjetje: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Auditit të Brendshëm gjatë viteve objekt auditimi ka funksionuar vetëm me 2 (dy) punonjës, konkretisht një shef sektori dhe një specialist, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik” dhe me pikën 3 (tre) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, i cili citon se “Njësia e auditit të brendshëm përbëhet jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 37-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5.1. Rekomandimi:

UAMD të marrë masa për plotësimin e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm me jo më pak se tre (3) punonjës, përfshirë edhe drejtuesin e njësisë, me qëllim forcimin e funksionimit të njësisë së auditit.

Vijimësi

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

Grupi i Auditimit

Muhamet Kavaja
Joniada GOÇAJ
Prishila RAMA